



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke



A.nr. 225/ 2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Adnan Konushevi dhe Zyhdi Haziri anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Lutfie M. Ajvazi, duke vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), paraqitur kundër koalicionit Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Partia Socialdemokrate (AAK&PSD), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes materialeve zgjedhore në hapësira publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.10.2019, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET si i palejuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV).

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesën me nr. Anr.225 më datë 04.10.2019, të paraqitur nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se me datën 04.10.2019 në Sheshin “Nëna Terezë” koalicioni AAK-PSD kanë vendosur një “Shtand”.

Koalicioni AAK-PSD në përgjigjen në ankesë të datës 04.10.2019 thekson se lidhur me këtë rast është vendosur me vendimin A.nr 184/2019.

PZAP-i, pas shqyrtimit të lejshmërisë së apelit gjeti se:

Apeli është i palejuar

Paneli pas shqyrtimit të ankesës gjeti se ankesa e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ka njëjtësi subjektive, objektive gjendje të njëjtë faktike me ankesën A.nr 184/2019 e datës 02.10.2019, e parashtruar nga i njëjti subjekt politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me datë 02.10.2019, kundër koalicionit AAK-PSD, e cila çështje ka përfunduar me vendimin e PZAP-it A.nr 184/2019, të datës 04.10.2019.

Nga kjo gjendje e vërtetuar faktike rezulton se ankesa e parashtruar nga subjekti politik i parashtruar nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV), është çështje e gjykuar “res iudicata”.

PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e në pajtim më dispozitat e nenit 11.5 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
A nr. 225/2019 më datën 05.10.2019

Kryesuesi i Panelit
Fejzullah Rexhepi



Këshillë Juridike: Kunder këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa conform nenit 118.4